

V E N D I M
Nr.488 datë 4.9.1995

**PËR VENDOSJEN E PULLAVE NË ARTIKUJT E DUHANIT DHE PIJEVE ALKOOLIKE
TË PRODHUARA NË VEND OSE TË IMPORTUARA**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Personat fizikë dhe juridikë që zhvillojnë veprimëtarinë e prodhimit e tregtimit në vend ose importimit të artikujve të duhanit dhe pijeve alkoolike, janë të detyruar të vendosin pullën nën letrën e tejdrukshme të çdo pakete cigareje dhe mbi kapak të çdo shisheje me pije alkoolike.

2. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të marrin masa për prodhimin e pullave brenda datës 25 shtator 1995. Pullat të jenë të veçanta për cigaret dhe për pijet alkoolike.

3. Çmimi i pullave për çdo kategorizim caktohet nga ministri i Financave.

4. Shitja e pullave është e lirë për çdo person fizik ose juridik.

Kërkesa për blerje paraqitet në drejtorinë e tatimeve në Ministrinë e Financave dhe duhet të shoqërohet me këtë dokumentacion:

a) Regjistrimin në gjykatë të subjektit.

b) Çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor të rrethit, ku e zhvillon veprimëtarinë prodhuese a tregtare.

c) Vërtetimin nga dega e tatimeve për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit deri në datën e paraqitjes së kërkesës për pulla.

ç) Vërtetimin nga bankat shtetërore të nivelit të dytë që nuk kanë kredi të pakthyera në afat.

d) Kontratën e lidhur me firmën prodhuese a tregtare, brenda ose jashtë vendit.

Të gjitha dokumentet e mësipërme depozitohen në drejtorinë e tatimeve në Ministrinë e Financave.

Një material përmbledhës për pullat e shitura i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

5. Ministrisë së Financave i shtohen 10 milionë lekë për prodhimin e pullave, që përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1995.

6. Mbas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, organet doganore e tatimore dhe policitë e tyre përkatëse doganore e tatimore kontrollojnë të gjitha prodhimet e duhanit dhe pijet alkoolike që qarkullojnë ose tregtohen pa pullë, si dhe marrin masat përkatëse në përputhje me legjislacionin doganor e tatimor në fuqi dhe me kompetencat që kanë sipas dekretit nr.1074, datë 21.4.1995 "Për shpërbërjen e policisë financiare dhe krijimin e policisë doganore dhe policisë tatimore", miratuar me ndryshime me ligjin nr.7938, datë 24.5.1995.

Mallrat e sekuestruara ruhen pranë degës së rezervave të shtetit të rrethit ku sekuestrohen, ose në degën e rrethit më të afërt.

7. Pullat cilësohen letra me vlerë dhe falsifikimi i tyre dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi më 15 tetor 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi